

Statistikat e Pyjeve dhe Biodiversitetit, 2020

Tiranë më 09 Shtator 2021: Në vitin 2020, fondi pyjor dhe kullosor i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.740.304 (ha), duke përfaqësuar 60,5 % të sipërfaqes gjithsej të vendit.

Tab.1 Bilanci Kadastral i Fondit Pyjor dhe Kullosor të Shqipërisë


Viti	Pyje		Kullota		Sipërfaqe me bimësi pyjore dhe jo-produktive		Gjithsej	
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2016	1.052.237	60,4	478.188	27,5	210.456.3	12,1	1.740.880	100
2017	1.051.871	60,4	478.081	27,5	210.387.8	12,1	1.740.339	100
2018	1.051.859	60,4	478.081	27,5	210.383.4	12,1	1.740.324	100
2019	1.051.843	60,4	478.081	27,5	210.382.5	12,1	1.740.307	100
2020	1.051.841	60,4	478.081	27,5	210.382.1	12,1	1.740.304	100

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Në 2020, pyjet shtrihen në një sipërfaqe 1.051.841 (ha), që përfaqëson 60,4 % të fondit pyjor dhe kullosor. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe 478.081 (ha) ose 27,5 % të fondit pyjor dhe kullosor. Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe jo-produktive të cilat janë pjesë e fondit pyjor zënë një sipërfaqe 210.382 (ha) ose 12,1 % të këtij fondi.

Në sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor në vitin 2020, si rezultat i dukurive natyrore dhe aktiviteteve njerëzore, ka një rënie me rreth 2,2 (ha), krahasuar me vitin 2019.


Fig. 1 Struktura e Fondit Pyjor dhe Kullosor (%) për vitin 2020



Për publikim 09/09/2021


Në vitin 2020, vëllimi i përgjithshëm i pyjeve, arrin në rreth 54.845.573 (m³), nga të cilat 94,0 % e këtij vëllimi përbëhet nga pyjet publike dhe 6,0 % nga pyjet private. Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve është ulur afërsisht me 1.113 (m³), krahasuar me vitin 2019.

Fig. 2 Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve (000/m³)



Në vitin 2020, në fondin pyjor sipërfaqen më të madhe e zënë fletorët me 49,8 %, ndjekur nga të tjera lloje me 35,8 % dhe halorët 14,3 % .

Fig.3 Fondi pyjor sipas strukturës së llojeve (ha)



Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë, janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ato ofrojnë.


Tabela 2, jep informacion mbi gjashtë kategoritë e zonave të mbrojtura sipas rëndësisë:

Tab. 2 Numri dhe sipërfaqja e zonave të mbrojtura

Kategoria e zonës së mbrojtura	Numri i zonave/(Nr)					Sipërfaqja (Ha)				
	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020
Rezervë Strikte Natyrore	2	2	2	2	2	4.800	4.800	4.800	4.800	4.800
Park Kombëtar	15	15	14	14	14	210.501	210.501	230.707	230.707	230.707
Monument Natyror	750	750	750	725	725	3.470	3.470	3.470	3.470	3.470
Rezervat Natyror i Menaxhuar	24	24	25	25	25	144.685	144.685	169.275	169.275	169.275
Peizazh i Mbrojtur	5	5	6	6	6	95.864	95.864	97.333	97.333	97.333
Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara	4	4	4	4	4	18.245	18.245	18.245	18.245	18.245
Gjithsej	800	800	801	776	776	477.566	477.566	523.831	523.831	523.831

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Zonat e mbrojtura në vitin 2020 zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 523.831/ha, duke përfaqësuar 30,0 % të sipërfaqes së fondit pyjor dhe rreth 18,0 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Në vitin 2020 nuk ka patur ndryshime në numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura.

Fig. 4 Sipërfaqja e zonave të mbrojtura sipas kategorive (%)

Në vitin 2020, sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë parqet kombëtare me 44,0 % të sipërfaqes gjithsej, ndjekur nga rezervatet natyrore të menaxhuara me 32,3 %, peisazhet e mbrojtura me 18,6 %, zonat e mbrojtura të menaxhuara 3,5 %, rezervatet natyrore 0,9 % dhe monumentet natyrore 0,7 %.

Metodologjia

Të dhënat mbi statistikat e pyjeve dhe biodiversiteti mbështeten në të dhënat administrative me bazë vjetore. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve.

Sipas Vkm Nr. 433, Datë 8.6.2016 për Transferimin Në Pronësi Të Bashkive Të Pyjeve Dhe Të Kullotave Publike. Informacioni mblidhet në të gjitha Bashkitë e vendit të cilat kanë detyrimin ligjor të raportojnë çdo tre muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave të pyjeve dhe biodiversitetit është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Përkufizime

Kadastra e pyjeve: është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

Fond pyjor: janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

Zonat e Mbrojtura: mund të kenë forma të ndryshme si, park kombëtar, zona të paprekura, zona të ruajtura nga komuniteti, rezervate natyrore dhe rezervate private natyrore. Sipas IUCN, "Një zonë e mbrojtur është një hapësirë gjeografike e mirë përcaktuar, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mënyrave ligjore ose metodave të tjera efektive, që sigurojnë mbrojtjen afatgjatë të natyrës dhe shërbimeve mjedisore të ekosistemeve që lidhen me të, si dhe vlerave kulturore."